

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

PARAQITJE PROJEKTI

FJALOR I MADH I GJUHËS SHQIPE (me rreth 90 000 fjalë dhe 10.000 njësi frazeologjike)

Emërtimi dhe adresa e institucionit që administron projektin
Ministria e Arsimit, e Rinisë dhe e Sporteve

Tel.

E-mail:

<p><i>1. Nënndarja ku do të realizohet projekti:</i></p> <p>Versioni A: Departamenti i Leksikologjisë dhe i leksikografisë, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike</p> <p>Versioni B: Pranë Akademisë së Shkencave, duke punuar si projekt i pavarur me hartues nga: Punonjës nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (ASA) Leksikografë profesionistë në pension Leksikografë nga IAP, Kosovë Leksikografë nga universitetet në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni</p> <p>Versioni C: Të krijohet Institut leksikografik, i cili ta ketë detyrë institucionale hartimin e veprës (të veprave në të ardhmen, me të paktën 15 leksikografë dhe 5 forca ndihmëse</p>	Adresa
<p><i>2. Institucionet që bashkëpunojnë:</i></p> <p>Akademia e Shkencave e Shqipërisë Akademia e Studimeve Albanologjike Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës Instituti Albanologjik i Prishtinës Universitetet në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Kozencë, Palermo</p>	Adresa

3. Titulli i projektit: **Fjalor i madh i gjuhës shqipe** (me rreth 90 000 fjalë dhe me rreth 10.000 njësi frazeologjike)

Objektivat e Programit të cilave u referohet Projekti:

I. Ky fjalor është veper madhore leksikografike, i domosdoshëm për të pasqyruar, për të ruajtur dhe për të hedhur në përdorim pasurinë më të madhe leksikore, frazeologjike e semantike të gjuhës shqipe. Gjuha shqipe është ndër të rrallat që nuk ka një fjalor të tillë. Fjalori do të jetë burim këshillimi, studimi e hartimi të fjalorëve të tjerë të tipeve të ndryshme. Fjalori do të jetë veper me rrezatim të gjerë përdorimi, për të gjithë ata që merren veçanërisht me gjuhën e shkruar, por edhe të folur, me krijime e me përkthime, me hartimin e fjalorëve të tipave të ndryshëm etj. (ai do të jetë i domosdoshëm për shkrimtarët e për publicistët, për shkollarët e për studentët, për mësuesit e për pedagogët, për studiuesit e për këdo që merret me përdorimin e kultivimin e gjuhës amtare).

II. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shkencore për hartimin e këtij Fjalori ka si përvojë hartimin e *Historisë së Shqipërisë*, të *Fjalorit enciklopedik*, natyrisht duke iu përmbajtur specificës së kësaj vepre.

III. Baza materiale kryesore për hartimin e këtij Fjalori do të jetë Kartoteka e leksikut të shqipes, e digjitalizuar, si edhe fjalorët e tjerë të shqipes. Vepra të tilla leksikografike si fjalori i madh kërkojnë domosdo shfrytëzimin e pasqyrimin e lëndës leksiko-frazeologjike e semantike të shqipes në gjithë shtrirjen e saj truallsore, kohore e të përdorur në shkruar e të folur. Prandaj bëhet e domosdoshme më parë të realizohet Kartoteka kombëtare e leksikut të shqipes e digjitalizuar, me akses të përgjithshëm të kontrolluar, në fazën e parë me shkrirjen e kartotekave të tilla në ASA, IAP, Kozencë etj. dhe më tej pasurimi i saj me vjelje integrale të veprave me gjuhë të pasur.

IV. Puna për hartimin e këtij Fjalori kërkon të përcaktohet sa më mirë shkencërisht sipas tipit të tij çfarë do të përmbajë ai dhe si do të jepet lënda e përfshirë në të. Fjalori i madh nënkupton jo vetëm rritjen e numrit të fjalëve, por edhe zgjerim të strukturave kuptimore dhe të formulimit të shpjegimeve. Parimet e përgjithshme e kriteret e veçanta të fjalorëve të tillë njihen në leksikografi, por zbatimi i tyre për lëndën e shqipes do të ketë edhe veçanti të përligjura.

a. Fjalori do të shënojë regjistrimin e parë të pasurisë më të madhe e më kryesore të fjalëve, të frazeologjisë e të

kuptimeve leksikore të gjuhës sonë, pasurinë e gjallë të gjuhës; do të jetë një vepër përgjithësuese që do të përfshijë shtresën më aktive të leksikut të shqipes dhe një pjesë të madhe të shtresës pasive, strukturat kuptimore të fjalëve dhe karakteristikat kryesore gramatikore, stilistike e shprehëse. Zgjerim do të kenë disa shtresa leksikore të pasuruara e të gjallëruara rishtas, si nga fushat e elektronikës dhe të informatikës, të finacave e të bankave, të artit e të kulturës, të biznesit, të organizimit shtetëror etj. Zgjerim do të kenë shtresat leksikore nga fusha e terminologjisë, e leksikut dialektor, e neologjizmave, e huazimeve të përligjura etj.

b. Në këtë vepër merr përparësi karakteri informues, pa përjashtuar edhe karakterin normative. Fjalori do të jetë gjithsesi vepër kodifikuese e normës leksiko-semantike të shqipes standarde; ai do të pasqyrojë njëherazi zhvillimet më të fundit të leksikut e të semantikës leksikore të gjuhës shqipe, gjallërimin e formimit të fjalëve të reja dhe ngjijtjen drejt standardit të leksikut krahinor, lëvizjet në shtresat leksikore e stilistike, shkallën e kristalizimit të normës gjuhësore etj.

c. Për herë të parë në këtë fjalor do të jepet dhe etimologjia e fjalëve të thjeshta, si dhe emërtimet në latinishte për termat e botanikës e të zoologjisë.

ç. Zgjerim proporcional do të kenë strukturat kuptimore të fjalëve dhe formulimet e shpjegimeve për sa më shumë informim e qartësi, po ashtu lidhjet sinonimike, shënimet për vlerat stilistike e përdorimet ligjërimore, ilustrimet me shembuj etj.

4. Afati: maj 2021 – maj 2025

Kohëzgjatja në muaj: 60 muaj

Grupi i hartuesve

Nr	Emër, mbiemër	Qendra e punës
1	Akad. Jani Thomai	në pension, Shqipëri
2	Prof. dr. Xhevat LLoshi	në pension, Shqipëri
3	Prof. dr. Emil Lafa	në pension, Shqipëri
4	Prof. dr. Miço Samara	në pension, Shqipëri
5	Prof. dr. Valter Memisha	ASA
6	Prof. dr. Hajri Shehu	në pension, Shqipëri
7	Prof. dr. Thanas Feka	në pension, Shqipëri
8	Prof. dr. Agron Duro	në pension, Shqipëri
9	Prof. dr. Artur Lamaj	ASA
10	Prof. dr. Ali Jashari	Universiteti i Korçës
11	Prof. dr. Qemal Murati	IAP, Kosovë
12	Prof. dr. Shefkije Islama	IAP, Kosovë
13	Prof. as. dr. Idriz Metani	Universiteti i Tiranës
14	Prof. as. Adelian Çerpja	ASA
15	Prof. dr. Bardhyl Demiraj (etimologji)	Munih, Gjermani
16	Dr. Naim Berisha	IAP, Kosovë
17	Prof. dr. Mustafa Ibrahim	USHT, Maqedoni
18	Akad. Gjovalin Shkurtaj	në pension, Shqipëri
19	Prof. dr. Prof. Seit Mansaku	në pension, Shqipëri
20	Prof. dr. Dhori Qiriaz	Universiteti "Aristoteli", Slanik, Greqi
21	Dr. Gëzim Gurgaj	Universiteti i Palermos, Itali
22	Prof. dr. Anila Omari	ASA
23	Prof. dr. Haki Ymeri	në pension, Shkup, MV
24	Prof. dr. Esheref Ymeri	në pension, Shqipëri
25	Prof. dr. Shezai Rrokaj	FHF, UT
26	Akad. Francesk Altimari	Kozencë, Itali
27	Akad. Rexhep Ismajli	AShAK
28	Prof. dr. Bardh Rugova	Universiteti i Prishtinës
29	Prof.as. dr Julian Kume	ASA
30	Prof. dr. Izmit Dyrmishi	USH i Tetovës, MV
31	Prof. as. Dr. Ajtene Qamili	Shkup, MV

Forcat ndihmëse

Nr	Emër, mbiemër	Qendra e punës
1	Engjellushe Karaj	ASA
2	Erjena Cenko	ASA
3	Ilirian Martiri	ASA
4	Dr. Afërdita Abdullahi	IAP, Kosovë
5	Dr. Manjola Zaçellari	U. i Durrësit

Shënime:

1. Lista e realizuesve të veprës është globale dhe e hapur, prej saj, me vendim të institucioneve shkencore bashkëpunuese, krijohet grupi realizues prej 15 gjuhëtarësh, që kanë përgatitjen më të mirë dhe përvojën e mjaftueshme për të punuar për hartimin e këtij Fjalori, duke marrë më parë mendimin e tyre, pëlqimin për projektin, pozicionin në grup, metodikën e punës, kohën që do të vënë në dispozicion, si edhe për vetë tipin e Fjalorit sipas këtij Projekti. Njohja e përdorimi i kompjuterit është kërkesë e vetë procesit si do të punohet në grup. Hartuesit e redaktorët do të përballojnë ngarkesën e ritmin e punës në grup dhe do të sigurojnë cilësinë e produktit të tyre shkencor. Redaktorët e redaksia do të caktohen më pas.

2. Markimet me ngjyra:

- me ngjyrw vjollcw, hartues nw pension nga Shqipwria
- pa markim, hartues nga Shqipwria (nw marrwdhwnie pune)
- me tw verdhw, hartues nga Kosova
- me tw kaltwr, hartues nga Italia, Greqia

Argumentimi shkencor i projektit

a. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:

Pas hartimit e botimit të disa fjalorëve shpjegues të tipit të vogël e të mesëm (“Fjalor i gjuhës shqipe”, 1954; “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe”, 1980; “Fjalor i shqipes së sotme”, 1984/2002; “Fjalor i gjuhës shqipe”, 2006; “Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe”, 1998; “Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe”, 1999 / 2010; “Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe”, 2004; disa fjalorë terminologjikë, mbi 30 fjalorëve krahnorë, të dhjetëra fjalorëve dygjuhësh etj.), hartimi i një fjalori të madh të shqipes është vepër e domosdoshme e kohës dhe sipërmarrje e mundshme për t’u përmbushur. Mundësinë e hartimit të kësaj veprë tashmë e krijojnë shumë faktorë: mbledhja e gjerë e lëndës leksiko-frazeologjike e semantike e shqipes së shkruar e të folur, studimi i saj në shumë aspekte e përpunimi leksikografik i pjesës thelbësore në fjalorë të tipeve të ndryshme; përfitimi i përvojës në hartimin e fjalorëve shpjegues me elementet kryesore të fjalorëve të mëdhenj (si zberthimi kuptimor etj.); përdorimi i teknikave e i metodave bashkëkohore në leksikografi (rrjeti kompjuterik, analiza semasiologjike, organizimi i punës mbi bazë projekti); përmbushja e kërkesave të praktikës gjuhësore për fjalorë të përdorimit të përgjithshëm etj.

Fjalori do të pasqyrojë sa më gjerë leksikon e shqipes me të gjithë përbërësit e tij: fjalë, kuptime, nuanca mbishtresore, lidhje sintagmatike të lira e frazeologjike, lidhje paradigmatiche, të dhëna gramatikore, stilistike e të përdorimit, shënime plotësuese dhe etimologjike etj. Në aspektin kombëtar Fjalori do të bëhet dhe një herë shprehësi më i plotë i pasurisë, i larmisë, i forcës dhe i bukurisë së gjuhës, i mundësive që jep ajo për të gjitha fushat e veprimtarisë së gjallë gjuhësore.

b. Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucione të tjera

Asnjë

c. Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj

Është hartuar *Parashtrësja e përgjithshme*

d. Referime kryesore të literaturës në lidhje me problemin

Fjalorët shpjegues të shqipes dhe të gjuhëve të huaja të tipit të mesëm e të madh; literaturë teorike leksikografike; literaturë për metodologjinë dhe praktikën bashkëkohore të hartimit të fjalorëve shpjegues kombëtarë të mesëm dhe të mëdhenj.

Objektivat e projektit

A. *Objektivi i zhvillimit*

Hartimi i *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe* njëvëllimësh me rreth 90.000 fjalë e 10.000 njësi frazeologjike, do të jetë vepër normative, me karakter të theksuar informues dhe normëzues, duke pasqyruar pasurinë më të vler të leksikore e semantike të shqipes bashkëkohore. Ai do të ketë *disa tipare të fjalorit të madh e të mesëm njëherazi*, si në numrin e fjalëve që do të përfshijë, në shkallën e zërthimit kuptimor të fjalëve, në llojin e ilustrimit me thënie e jo me shembuj burimorë, në referimet për lidhjet sinonimike, atonimike, në shënimet përkatëse gramatikore, stilistike, në shënimet etimologjike për fjalët e thjeshta, në emërtimet shkencore latinisht të bimëve e të kafshëve etj.

B. *Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme*

Objektivi 1:

- Hartimi i dhe diskutimi i “Parimeve e i kriterëve të fjalorit”
- Diskutimi përfundimtar rreth tipit të fjalorit, të teknologjisë e të teknikës leksikografike
- Caktimi i redaksisë shkencore të Fjalorit
- Përcaktimi i mënyrës së punës hartuese, i mënyrës së komunikimit dhe i bashkëpunimit midis hartuesve dhe hartuesve me redaktorët e kryeredaktorin dhe i modaliteve të tjera që lidhen me një punë që, megjithëse nënkupton punë në grup dhe konsultim të çdoastshëm midis leksikografëve, në gjendjen e sotme paraqet vështirësi të skajshme, sepse hartuesit nuk janë brenda një institucioni, çka do të thotë sinkronizim, harmonizim dhe bashkëpunimi i pashkëputur. Hartuesit janë nga disa vende dhe pavarësisht, komunikimit elektronik (internet etj.) një vepër e tillë kërkon grupim forcash. Gjithashtu, forcat hartuese janë në marrëdhënie kohore me procesin e punës për fjalorin jo në kushte të barabarta. Një pjesë e tyre janë në marrëdhënie të tjera pune me institucione shtetërore (pra nuk mund të puojnë me kohë të plotë).

Objektivi 2: (Parësor dhe determinues)

- **Krijimi i Kartotekës Kombëtare të leksikut të Shqipes.** Kartoteka Kombëtare, pa të cilin nuk mund të fillojë puna për hartimin e veprës, duhet të përfshijë, në pamundësi fizike, në formë elektronike gjithë korpuset leksikore e frazeologjike që janë krijuar sot në Shqipëri e jashtë saj (institucionalisht dhe privatisht). Kjo kërkon bashkëveprim institucional, por dhe ndërhyrjen e shtetit (Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, etj.), sepse pengesat janë jo të pakta dhe kapërcimi i tyre kërkon kosto të madhe financiare.

Objektivi 3: Fillimi i procesit hartues

- a. Fillimi i punës për përzgjedhjen e fjalëve e të njërive frazeologjike, pra hartimi i fjalësit të veprës (rreth 100.000 njësi)
- b. Ndarja e shkronjave ndërmjet hartuesve dhe fillimi i punës përzgjedhëse
- c. Hartimi i një shkronje si gjedhe / model pune
- d. Hartimi i veprës;
- e. Redaktim, unifikim, plotësim, korrektim në vazhdimësi

c. Kontributet specifike të projektit në shkencat fundamentale dhe/ose të aplikuara (përfshirë patenta, etj.)

Fjalori i madh i gjuhës shqipe me 100.000 zëra leksikografikë (rreth 90.000 fjalë dhe rreth 10.000 njësi frazeologjike) është sot vepra leksikografike e munguar, prandaj është edhe më e kërkuara nga shumë përdorues të gjuhës shqipe (nga studiuesit, nga leksikografët e veprave dygjuhëshe, nga shkolla, nga përkthyesit, nga krijuesit, nga publicistika, nga tekst-hartuesit et). Ky fjalor, duke pasqyruar në një shkallë të re pasurinë leksikore të shqipes bashkëkohore në një masë dy herë a më shumë se sa fjalorët e mëparshëm, në aspektin kombëtar, do të bëhet dhe një herë shprehësi më i plotë i pasurisë, i larmisë, i forcës dhe i bukurisë së fjalës shqipe pa kufizime territoriale, autoriale, mendësore etj., do të mishërojë pasurinë me vlera shënuese e shprehëse më jetësore të shqipes, do të krijojë kështu mundësi të pafundme, me lëndën e vet, që ajo t'i kryejë fuqishëm, me pasuri e me hijeshi funksionet komunikuese. Fjalori do të japë zgjidhje sipas normës së standardit gjuhësor, do të ndihmojë për ruajtjen e pastërtisë së shqipes, do të ndihmojë edhe shkollën për njësimin gjuhësor sipas shqipes standarde. Ai do t'u shërbejë gjithashtu të huajve që mësojnë e studiojnë shqipen thellësisht.

**PËRLLOGARITJE FINANCIARE PËR HARTIMIN E “FJALORIT TE MADH TË GJUHËS SHQIPE”
(ME RRETH 90.000 FJALË DHE 10.000 NJËSI FRAZEOLOGJIKE)
(Pagesa honorarësh)**

I. Parashikimi financiar:

Nëqoftëse hartuesit do të shkëputen nga puna dhe do të punojnë si një institucion i pavarur, duhen llogaritur pagat e mëposhtme (sipas gjendjes së tanishme):

1. 15 profesorë x 135.000 rroga mujore x 48 muaj (hartimi 4 vjet minimalisht) = 97.200.000 lekë
2. 5 forca ndihmëse x 700.00 rroga mujore x 48 muaj = 16.800.000 lekë
3. Meqenëse vepra do të hartohet nga leksikografë edhe jashtë Shqipërisë, përveç komunikimeve on-line, do të bëhen takime dymujore ose tremujore. ~ 20.000 euro – 2.460.000 lekë
4. Bazë materiale: 15 kompjutera, tre printera, dy skanera etj. – 20.000 euro = 2.460.000 lekë
5. Botimi: (fillimisht) 2.000 kopje x 2.000 lekë kostoja e një copjeje = 4.000.000 lekë

Gjithsej: 122.920.000 lekë ose 1.000.000 euro

II. Zërat që do të paguhet pasi të botohet vepra, si e drejtë autori me 40% të vlerës së veprës:

1. Pagesa për hartimin të fjalorit sipas VKM, nr. 120, dt. 27.1.1997, pika VI 5/a)
2. Hedhje në kompjuter sipas VKM, nr. 120, dt. 27.1.1997, pika XVIII/2a)
3. Për korrigjime teknike sipas VKM, nr. 120, dt. 27.1.1997, pika XVII/6
4. Për redaktimin letrar sipas VKM, nr. 120, dt. 27.1.1997, pika XVII/1
5. Për redaktimin shkencor sipas VKM, nr. 120, dt. 27.1.1997, pika XVII 2/a
6. Për formatim sipas VKM, nr. 120, dt. 27.1.1997, pika XIX/b
7. Për recensa

III. Arsytimet rreth kostos financiare së realizimit

1. Shuma e përgjithshme prej rreth 1.000.000 euro, në pamje të parë, duket e madhe. Por për vepra të tilla madhore, të vëllimshme, me cilësi të lartë shkencore e me vlera të përhershme kombëtare, ajo është e motivuar. Ndërkaq ajo zbutet përmes zgjidhjeve e procedurave të mëposhtme.

2. Meqenëse vepra është ndërmarrje shkencore mbarëkombëtare, është e natyrshme që financimi duhet të bëhet nga shtetet bashkëpunuese, Shqipëri, Kosovë e Maqedoni e Veriut, me një raport, f.v., 5:3:2 (500.000 euro Shqipëria, 300.000 euro Kosova, 200.000 euro MV).

3. Këto shuma, të shtrira në 4 vjet, nuk do të kenë peshë të madhe në buxhet, sepse i bie që për çdo vit Shqipëria të financojë 125.000 euro, Kosova 75.000 euro, MV 50.000 euro.

4. Mendojmë gjithashtu që Fjalori, kështu siç paraqitet, duhet të realizohet si projekt i veçantë, pa prekur buxhetin e AShSh a të institucioneve të tjera bashkëpunuese, duke u bërë kërkesë Qeverisë së RSh, Qeverisë së RK dhe Qeverisë së RMV, në kuadrin e marrëveshjeve për bashkëpunim kombëtar në fushën e arsimit, të shkencës dhe të kulturës (kujtojmë një bisedë të tillë që është bërë dhe është pranuar si zgjidhje, ndërmejt Ministrin të Arsimit, të Rinisë e të Sportit të Shqipërisë dhe Ministrin të Arsimit të Kosovës, në vitin 2018, në Prizren).

5. Ekonomizim në fonde mund të bëjnë edhe vetë akademitë e institucionet bashkëpunuese, sidomos në ngritjen e bazës materiale për leksikografi, në proceset e punës për kartotekën kombëtare elektronike të leksikut të shqipes etj.

6. Mendojmë se zgjidhja më e mirë e mundshme, përfundimtare e me perspektivë të gjatë, do të ishte që, pranë AShSh, të ngrihet Instituti Leksikografik i Gjuhës Shqipe, me një trupë fillesatare prej 15 leksikografësh e 5 forca ndihmëse. Ky institut nuk do të kërkonte financime për projekte, por financime të planifikuara pagash. Instituti, pas hartimit të Fjalorit të madh sipas këtij projekti, do të vijonte punën për hartimin e veprave të tjera sipas planeve afatmesme a afatgjata shkencore leksikografike, - një fushë shkencore e përhershme. Një model i një institucioni të tillë, i njohur edhe në vende të tjera, është trupëzuar gjatë vitit 2019 pranë Ministrisë së Diasporës në RSh, - “Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët”. Besojmë se Instituti do të krijojë produkte shkencore me shumë vlerë mbarëkombëtare dhe do ta përligjë veten.

Një mundësi e dytë ose variant plotësues:

**AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

“FJALOR I MADH I GJUHËS SHQIPE”

(me rreth 100 000 fjalë e njësi frazeologjike)

I. Parashtrësë e përgjithshme

Hartimi i një fjalori me vëllim të tillë kërkon një grup leksikografësh me përvojë dhe një punë të ngulët disavjeçare, por vepra e kryer mirë e vlen kohën e mundin: në rastin e shqipes, kur mungon një fjalor i tillë, ai do të shënojë edhe regjistrimin e parë të pasurisë më të madhe e më kryesore të fjalëve, të frazeologjisë e të kuptimeve leksikore të gjuhës sonë, pasurinë e gjallë të gjuhës, për ta ruajtur nga humbja dhe për t’ua dhënë gjithë atyre që merren veçanërisht me gjuhën e shkruar, por edhe të folur, me krijime e me përkthime, me hartimin e fjalorëve të tipeve të ndryshme etj. Në prerjen e sotme Fjalori do të pasqyrojë po ashtu zhvillimet më të fundit të leksikut e të semantikës leksikore të gjuhës shqipe, gjallërimin e formimit të fjalëve të reja dhe ngjitjen drejt standardit të leksikut krahinor, lëvizjet në shtresat leksikore e stilistike, shkallën e kristalizimit të normës gjuhësore etj.

Njihet tashmë që një folës i zakonshëm përdor në të gjitha situatat ligjërimore e shumta deri në 5 000 fjalë. Te veprat e shkrimtarëve të mëdhenj thuhet se arrin deri në 20 000 fjalë fjalori i përdorur. Në të dyja rastet strukturat kuptimore të fjalëve të përdorura janë shumë më të ngushta sesa ato që jepen ndër fjalorët e tipit të mesëm. Pra, një fjalor me rreth 50 000 fjalë do të ishte i mjaftueshëm për pëdorim praktik nga të gjithë. Fjalorët shumëvëllimësh e me 90. 000 fjalë a më shumë “e bjerrin” disi vlerën praktike masive x dhe shtojnë vlerat që i përmendëm më lart.

Është e njohur gjithashtu që për të përdorur një fjalor alfabetik duhet të dish ç’fjalë do të kërkojë në të. Për të zbuluar fjalë që nuk i dimë, d.m.th. që nuk i kemi dëgjuar ndonjëherë e nuk i kemi lexuar kund, do të duhej një fjalor analogjik a ideografik. Kështu shërbejnë edhe fjalorët alfabetiko-ideografikë, në të cilët përdoren edhe skica a fotografi. Në kushtet tona mund të ndërmerim vetëm hartimin e një fjalori alfabetik të pastër.

Pas hartimit e botimit të disa fjalorëve shpjegues të tipit të vogël e të mesëm (*Fjalor igjuhës shqipe*, 1954; *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, 1980; *Fjalor i shqipes së sotme*, 1984/2002; *Fjalor i gjuhës shqipe*, 2006; *Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe*, 1998; *Fjalorfrazeologjik i gjuhës shqipe*, 1999; *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, 2004; disa fjalorë terminologjikë, krahinorë, dygjuhësh, të autorëve etj.), hartimi i një fjalori më të madh të shqipes është një vepër e domosdoshme e kohës dhe e mundshme për t’u përmbushur. Të mundshme këtë vepër tashmë e bëjnë shumë faktorë: mbledhja e gjerë e lëndës leksiko-frazeologjike e semantike e shqipes së shkruar e të folur, studimi i saj në shumë aspekte e përpunimi leksikografik i pjesës thelbësore në fjalorë të tipave të ndryshëm; përftimi i përvojës në hartimin e fjalorëve shpjegues me elementet kryesore të fjalorëve të mëdhenj (si zbërthimi kuptimor etj.); përdorimi i teknikave e i metodave bashkëkohore në leksikografi (rrjeti kompjuterik, analiza semasiologjike, organizimi i punës mbi bazë projekti); përmbushja e kërkesave të praktikës gjuhësore për fjalorë të përdorimit të përgjithshëm etj.

Ky fjalor do të pasqyrojë sa më gjerë leksikon e shqipes me të gjithë përbërësit e tij: fjalë, kuptime, nuanca mbishtrësore, lidhje sintagmatike të lira e frazeologjike, lidhje paradigmatiske, të dhëna gramatikore, stilistike e të përdorimit, shënime plotësuese dhe etimologjike etj. Në aspektin kombëtar ata janë shprehësit më të plotë të pasurisë, të larmisë, të forcës e të bukurisë së gjuhës, të mundësive që jep ajo për të gjitha fushat e veprimtarisë së gjallë gjuhësore.

Parimet e kriteret e përgjithshme, që shërbejnë si mbështetje për hartimin e këtij fjalori më të madh, janë të njohura në teorinë e praktikën leksikografike dhe nuk e ndiejmë të nevojshme t’i shtojmë e t’i interpretojmë radhazi. Të tilla janë: koncepti, teoria e gjendja e gjuhës standarde, e përditësuar me vështrimin e ri për standardet gjuhësore dhe për shqipen standarde sot; koncepti, teoria e gjendja e normës gjuhësore; koncepti për shtresat leksikore, veçanërisht për leksikon krahinor; kriteret për zgjedhjen e fjalëve, për shpjegimin e për ilustrimin e tyre dhe teknika leksikografike e paraqitjes në fjalor etj. Ndërkaq do të mbahet parasysh që specifika nuk qëndron aty në teorinë leksikografike, sesa në sendërtimin e kësaj teorie në fushën e hartimit të fjalorëve të shqipes a me shqipen.

“Fjalori i madh i gjuhës shqipe” dyvëllimsh duhet të ketë disa tipare të fjalorit të madh e të mesëm njëherazi, si në numrin e fjalëve që do të përfshijë, në shkallën e zërthimit kuptimor të fjalëve, në llojin e ilustrimit me thënie e jo me shembuj burimorë, në shënimet etimologjike për fjalët e thjeshta, në emërtimet shkencore latinisht të bimëve e të kafshëve etj.

1. Si *fjalor i madh* ai do të përfshijë gjerësisht shtresën aktive dhe pjesën më të madhe të shtresës pasive të leksikut, të frazeologjisë e të semantikës leksikore shqipe, duke zgjeruar kufijtë historikë përtej Rilindjes Kombëtare dhe kufijtë e rrafshëve të gjuhës (të të folmeve, të ligjërimeve e të stileve). Rrjedhimisht, brenda këtij fjalori do të zënë vend më shumë fjalë të vjetra (edhe të vjetruara), më shumë krijime të reja (produkt i gjallërimit të ndjeshëm të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme shqipe me prejardhje e me përbërje) dhe më shumë sidomos fjalë, shprehje e kuptime nga ligjërimet popullore (nga të folmet), që janë të brumit të shqipes, që janë përdorur ose që mund të përdoren në ndonjë variant të gjuhës së folur a të shkruar. Është e kuptueshme që, në dritën e konceptit të sotëm për statusin e leksikut e për normën leksikore, për gjuhët kombëtare e për “purizmin”, për marrëdhëniet ndërgjuhësore e për prirjet integruese globale, për varësinë e ndërsjellë të faktorëve gjuhësorë e jashtëgjuhësorë (etnolinguistikë, sociolinguistikë, psikolinguistikë), do të zgjerohet disi edhe shtresa e fjalëve të huazuara, veçanërisht e ditëve tona, por pa synuar që ky fjalor të plotësisojë kërkesat e një fjalori huazimesh në gjuhën shqipe. Pra, zgjerim të ndjeshëm do të kenë kryesisht shtresa e fjalëve krahinore të brumit të shqipes dhe krijimet e reja në terminologji e në leksikon e përgjithshëm (nga shkrimtarët, publicistët, përkthyesit etj.), të përhapura e me vlera pasuruese, duke dhënë edhe shumë fjalë nga modelet fjalëformuese, që në fjalorët e mëparshëm janë pasqyruar në mënyrë të kufizuar si “të vetëkuptueshme dhe të lehta për t’u formuar nga çdo shqipfolës”.

2. *Makrostruktura* e fjalorit do të ketë zgjerim në të tri përbërësit themelorë të fjalorëve të këtij tipi: në fjalësin (glosarin), në semantikën leksikore dhe në sintagmatikën e njëjive leksikore (ilustrimin me më shumë thënie të domosdoshme).

Fjalësi do të nxirret nga regjistri i përgjithshëm i Kartotekës së leksikut të shqipes dhe nga vetë kjo kartotekë (KLSH), nga fjalorët (shpjegues, sinonimikë, frazeologjikë, terminologjikë e sidomos krahinorë të kohëve të fundit), nga filialja e KLSH me lëndë të re të vjelë gjatë 15 vjetëve të fundit, nga kartoteka e gramatikës etj.

Meqenëse Kartoteka e sotme e leksikut të shqipes nuk mundëson cilësinë e plotë të një vepre të tillë, duhet të ngrihet sa më shpejt Kartoteka kombëtare e leksikut të shqipes pa të cilën nuk duhet të fillojë puna për hartimin e veprës. Ajo duhet të përfshijë, në pamundësi fizike, në formë elektronike gjithë korpuset leksikore e frazeologjike që janë krijuar sot në Shqipëri e jashtë saj (institucionalisht dhe privatisht). Kjo kërkon bashkëveprim instiucional, por dhe ndërhyrjen e shtetit (Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit etj.), sepse pengesat janë jo të pakta dhe kapërcimi i tyre kërkon kosto të madhe financiare.

Fjalësi do të zgjidhet duke e gjykuar jo vetëm nga vlerat e fjalëve të veçuara, por edhe nga raporti i shtresave, i klasave e i fushave leksikore (të përgjithshme, të kufizuara, terma, neologjizma etj.), në përputhje me kriteret sipas tipit të fjalorit. Përpjesëtimet do të ruhen sa më shumë edhe për paradigmat leksikore, si për sinonimet, për antonimet, për emrat e mbiemrat prejfoljorë, për formimet me ndajshesa të specializuara ose me përbërje modelore etj. Paraprakisht mendohet që Fjalori të ketë rreth 90.000 fjalë e rreth 10.000 njësi frazeologjike dhe të botohet në dy vëllime. Ka mendime për një fjalor edhe më të madh, deri 100.000-110.000 fjalë, në 3-4 vëllime, por ky fjalor kërkon një projekt të veçantë dhe gjithsesi do të rëndohej më shumë nga fjalët e huaja e speciale, nga variantet e shumta fjalëformuese dhe nga fjalët të tjera të kufizuara, që e kanë vendin në fjalorë të veçantë (të fjalëve të huaja, terminologjikë, krahinorë, neologjizmas etj.), të cilët prandaj edhe kanë hyrë në tipologjinë leksikografike. Fjalori mund të ketë edhe botim elektronik, të qarkullojë në CD ose në faqe interneti.

Semantika leksikore do t’u përgjigjet kriterëve e përmasave të fjalësit. Prirjet kryesore do të jenë dy: a) Pasuri sa më madhe e strukturave kuptimore të fjalëve, duke sjellë në fjalor kuptime të reja që kanë fituar fjalët, kuptime që në fjalorët e mëparshëm nuk janë dhënë për arsye të ndryshme, zhvillime semantike letraro-gjuhësore me prirje drejt leksikalizimit etj.; b) trajtim analitik i tipologjisë semantike, d.m.th. jo sinteza kuptimore drejt kuptimesh të përgjithshme, por veçimi i kuptimeve sipas tipit (konkret / abstrakt, i drejtpërdrejt / i figurshëm etj.), gjë që siguron pasqyrimin e nuancave më të holla kuptimore dhe të vlerave shprehëse-emocionuese të fjalëve.

Sintagmatika e njëjive leksikore, sipas ndërtimit e raporteve të brendshme dhe sipas informacioneve plotësuese që sjell, do të jetë më e gjerë dhe do të udhëhiqet nga të njëjtat kërkesa të fjalorëve që e përdorin atë (plotësimi e qartësimi i përmbajtjes leksikore të fjalëve, zbulimi i vlerave të mbishtresuara që nuk jepen plotësisht nëpërmjet shpjegimeve e shënimeve të posaçme, dëshmimi i përdorimit të fjalëve në ato kuptime në lidhje sintagmatike të ndryshme, me kuptimet gramatikore të mundshme, në fusha të ndryshme të gjuhës ose në situata të ndryshme ligjërimore etj.).

3. *Mikrostruktura* e fjalorit do të zërthejë më tej tipin e makrostrukturës në paragrafin leksikografik për çdo fjalë, duke iu përgjigjur në radhë të parë përmasave të saj, d.m.th. do të ketë afërsisht atë gjerësi, atë analitizëm

dhe ata përbërës që i kërkon makrostruktura e një fjalori të këtij tipi, e plotësuar me elementet specifike të mikrostrukturës.

Fjala në fjalor do të jepet leksikografikisht sipas traditës së fjalorëve të deritashëm të shqipes e të gjuhëve të tjera: në trajtën përfaqësuese, me trajta plotësuese të temave themelore, me shënimet e nevojshme gramatikore për pjesët e ligjëratës dhe për kuptimet gramatikore bazë dhe me shënimet e nevojshme stilistike e të përdorimit të gjallë të fjalës, përgjithësisht më të pasura se në fjalorët e tipit të mesëm. Veç këtyre, ky tip fjalori kërkon që fjalët e parme të shoqërohen me etimologjinë e tyre dhe emrat e kafshëve e të bimëve me emërtimin shkencor në latinishte.

Semantika leksikore në mikrostrukturë do të lidhet me strukturën kuptimore të fjalëve, e cila do të jetë më e gjerë e më analitike se në fjalorët e tipit të mesëm. Po ashtu, vetë shpjegimet e kuptimeve do të jenë më të gjera për të qenë sa më të plota e të qarta, do të japin sa më shumë elemente të kuptimit e të nuancave kuptimore, të ngjyrymeve të ndryshme, të veçorive të përdorimit etj., që do të thotë se do të përmbajnë të shprehur më shumë përbërës kuptimorë (sema). Kjo do të sjellë që edhe lidhja e prejardhjes së kuptimeve nga njëri-tjetri do të dalë më e qartë, kurse në fjalët e prejardhura e të përbëra do të dalë më qartë edhe lidhja e kuptimeve me strukturën fjalëformuese të njërive leksikore.

Sintagmatika e fjalës do të jepet me anë të togfjalëshave dhe të fjalive të shkurtra 3-4 gjymtyrëshe (pa shënime për burimin). Meqë nuk do të ketë shembuj me referim të burimit, paragrafi i thënieve do të rritet, natyrisht me thënie të nxjerra nga shembujt që jep KLSH. Kriteri i zgjedhjes së togfjalëshave do të jetë vlera e tyre dëshmuar semantike, shprehëse-stilistike, gramatikore etj., pa përsëritur njëri-tjetrin; do të vlerësohet edhe estetika e shprehjes. Jo të gjitha fjalët dhe jo të gjitha kuptimet e një fjale do të shoqërohen me sintagmatikën e vet; kjo do të bëhet kryesisht për fjalë e kuptime që kanë nevojë për vlerat plotësuese që sjellin këto mjete të sintagmatikës.

Gjatë hartimit të Fjalorit do të përfitohet nga përvoja evropiane në këtë fushë, do të konsultohen e do të shfrytëzohen fjalorët e mëdhenj të anglishtes, të frëngjishtes, të italishtes, të rusishtes etj., jo thjesht si tipe a modele leksikografike, por edhe si burim lënde e në shpjegime, veçanërisht për terminologjinë ndërkombëtare, për disa fjalë të huaja, për fjalë që shprehin pa farë dallimi të njëjtin koncept etj.

4. Rrjedhim i tipit të fjalorit do të jetë edhe ndryshimi i raportit ndërmjet *funksionit informues dhe funksionit normativ*: funksioni informues në fjalor do të rritet më shumë, krahasuar me fjalorët e vegjël e të mesëm, si në fjalës, edhe në përbërësit e tjerë të makrostrukturës e të mikrostrukturës. Norma gjuhësore e standardit në fjalor do të përcaktohet jo thjesht nëpërmjet përjashtimit, por shpesh nëpërmjet kufizimeve me shënime e nevojshme të elementeve jonormë (të fjalëve e të kuptimeve të vjetruara, krahinore, të huaja etj.). Fjalëve krahinore shqipe dhe krijimeve të reja me mjetet e sipas modeleve të shqipes do t'u hapet rruga për përgjithësim e drejt standardit, duke mos i kufizuar me shënime të posaçme për burimin e tyre. Mjet e mënyrë dallimi ndërmjet normës e jonormës do të jetë edhe tipi i shpjegimit (do të ketë më shumë shpjegime me sinonimi për njësitë e kufizuara). Por, në pajtim me veçoritë e normës leksikore (shumë më e çlirët se norma fonetike e ajo gramatikore), cilësimi i jonormës përballë normës do të bëhet vetëm në raste krejt të qarta e të domosdoshme. Fjalori, kur është rasti, nuk do të synojë t'u mbyllë dyert fjalëve, shprehjeve e kuptimeve, por do t'i hedhë ato të konkurrojnë lirisht e të provohen realisht në truallin e përdorimit të gjallë ligjërimor, pavarësisht nga burimi krahinor, nga krijuesi, nga mosha etj.

Zbërthim e konkretizim të mëtejshëm të mënyrave dhe të mjeteve të pasqyrimin të makrostrukturës e të mikrostrukturës në fjalor, në trajtë kriteresh e të teknikës leksikografike për hartimin e fjalorit, përfshirë gjithçka që është ngulitur tashmë në praktikën leksikografike nga tradita shqipe e botërore, do të ketë edhe në punë e sipër, duke vlerësuar me përparësi diskutimet e mendimet e gjuhëtarëve, por edhe të atyre që e kërkojnë një fjalor të tillë.

Hartimi i fjalorit *bëhet mbi bazën e një projekti*, i cili, sipas kërkesave të punës me projekt, parashikon strukturën shkencore të fjalorit, vëllimin, grupin e hartuesve, redaktorët (redaksinë), punonjës ndihmës (operatorë, korrektorë, kartelistë etj.), leksikografët bashkëpunues, përfituesit e drejtpëdrejtë e të tërthortë, afatet, bazën materiale e teknike (aparatura, literaturë leksikografike, kanceleri ...), llogaritjet financiare etj. Çdo fjalori i madh është afatgjatë jo vetëm në procesin e hartimit, por edhe në jetën e vet të qarkullimit e të përdorimit: duhet të kalojë një kohë e gjatë që të rimerret hartimi i një fjalori tjetër të madh ose të ripunohet fjalori i botuar. Prandaj edhe cilësia e tij duhet t'i qëndrojë kësaj kohe dhe ripunimet e fjalorit a vëllimet shtesë të mos ndihen aq shpejt të nevojshme.

Për shkak të vëllimit të madh dhe të të dhënave shumanëshe, hartimi i kësaj vepre kërkon patjetër thithjen e *bashkëpunimin e specialistëve* më të mirë të gjuhësisë shqipe dhe të fushave të tjera për konsultim, që mund t'u japin zgjidhje të sigurtat kërkesave shkencore të Fjalorit. Si rrjedhim fjalori duhet konceptuar si vepër mbarëkombëtare. Forca plotësuese do të duhen edhe në nivel të mesëm, për vjelje, skedim e alfabetizim, për punë me KLSH, për korrigjime etj. dhe për kompjuterizim, formatim etj.

Ky Fjalor do të jetë krejt i ri, me dallime të rëndësishme në vëllimin e lëndës dhe në trajtimin leksikografik. Ai nuk do të dalë nga një rritje mekanike e numrit të fjalëve, por nga hartimi tërësor si një vepër e re, natyrisht duke u mbështetur në gjithë trashëgiminë tonë leksikografike. Çdo vit do të ketë vjelje të reja fjalësh, kuptimesh, njësis

frazeologjike, në mënyrë që vëllimi i fjalorit të përditësohet me lëndë të re deri në çastin e botimit. Problemet e karakterit organizativ e financiar mund të zgjidhen vetëm nga organet zyrtare të ASH dhe të QSA.

Realizuesit e veprës dhe grupet e punës caktohen nga dy ASH dhe ASA. Parashikohet që *hartimi* i fjalorit të përfundojë për 2-3 vjet që nga fillimi i punës hartuese. Vëllimi dhe vështirësitë e hartimit të një vepre të tillë madhore në gjuhësi kërkojnë harmonizim të punës së hartuesve e të redaktorëve për të siguruar njësimin e veprës me shumë autorë.

II. Puna për fjalorin

Këtu po shtrojmë në trajtë detyrash, udhëzimesh e kriteresh disa nga kërkesat kryesore për këtë Fjalor. Disa kritere e udhëzime specifike për fjalorin do të plotësohen në përputhje me gjendjen e lëndës, të grupeve të punës e të kushteve të tjera për çdo vëllim.

Fjalësi:

a) Lënda do të ndahet ndërmjet hartuesve sipas shkronjave.

b) Fjalësi i shkronjave do të ndërtohet nga hartuesi përkatës, duke shfrytëzuar Kartotekën e leksikut të shqipes (me filialen e re të saj, blloqet e regjistrimit të përgjithshëm të KLSH, fjalorët shpjegues të shqipes, fjalorët sinonomikë, fjalorin frazeologjik, disa fjalorë krahinorë, disa fjalorë shqip – gjuhë e huaj, si edhe vjeljet vetjake). Siç u tha, fjalësi do të parashikojë zgjerimin e leksikut të shqipes me njësi nga burimet popullore e nga krijimtaria e shkrimtarëve a e përkthyesve, por edhe me fjalët e huaja të domosdoshme, të huazuara kohët e fundit në fusha të reja.

c) Një listë e plotë e termave shqip e të huaj, që duhet t'i ketë Fjalori, mund të nxirret nga terminologë, duke vjelë fjalorët terminologjikë të botuar deri më sot.

ç) Fjalët do të shoqërohen me ato trajta plotësuese dhe me ato shënime gramatikore e shprehëse-stilistike si në fjalorët e mëparshëm shpjegues. Shpjegime më të hollësishme jepen në një udhëzues të veçantë.

d) Për të zvogëluar vëllimin fizik të librit në botim, mund të zbatohet sistemi i paraqitjes së lëndës si në *“Fjalorin e gjuhës shqipe”*, 2006, d.m.th. gërshetimi i sistemit leksemor me atë çerdhor në paragrafin e fjalëve me njësi të prejardhura drejtpërdrejt prej fjalës bazë dhe që shpjegohen zakonisht me anë formulash tipe.

Kuptimet:

a) Zbërthimi kuptimor do të jetë i plotë, duke ndarë si kuptime më vete gjithë njësitë semantike që dallohen nga përbërësit themelorë ose nga shumica e përbërësve (përfshirë figurshmërinë, grupet e realieve që u referohen etj.).

b) Kuptimet do të renditen në kryeradhë, sipas prejardhjes e sipas vlerës në gjendjen e sotme të përdorimit.

Shpjegimet:

a) Shpjegimet do të jenë sa më të plota, por pa tepri fjalësh të panevojshme, të thjeshta, të ndërtuara drejt sipas normës.

b) Për shpjegimet do të shfrytëzohen fjalorët e mëparshëm, por do të jenë në pajtim me realitetin gjuhësor të sotëm dhe me atë që jep lënda e Kartotekës, në pajtim me tipin e fjalorit.

c) Meqë Fjalori do të zgjerohet me fjalë krahinore, të reja, të huaja etj., të cilat mund të kenë një sinonim më të përgjithshëm a më të njohur, do të përdoret më dendur shpjegimi me sinonim. Por edhe kur jepet një shpjegim perifrastik a shpjegues, do të jepen sinonimet kryesore të fjalës në atë kuptim, sikundër edhe antonimet e mundshme.

ç) Në fjalët e prejardhura e të përbëra do të shfrytëzohet për shpjegim edhe motivi semantik fjalëformues, d.m.th. përmbajtja reale e gjymtyrëve ose figura gjuhësore sipas së cilës ka lindur kuptimi i figurshëm. Me mënyrat e njohura leksikografike ky motiv do të bëhet sa më i dukshëm, në mënyrë që të lehtësohet rrokja sa më e plotë e sa më e saktë e kuptimit në tërësi.

d) Si strukturat kuptimore, ashtu edhe shpjegimet do të krahasohen me ato të sinonimeve e të antonimeve të fjalës, të fjalëve të së njëjtës paradigme (fjalëformuese, leksiko-gramatikore etj.) ose të së njëjtës fushë leksikore.

dh) Shpjegime do të ketë edhe për thënie e togje fjalësh që jepen në fjalor dhe që kanë nevojë për shpjegime të tilla.

e) Shpjegimet do të jenë filologjike. Të dhënat enciklopedike mund të përdoren vetëm në raste të domosdoshme dhe kur ndihmojnë për qartësinë e shpjegimit filologjik.

Shembujt:

Shembujt në Fjalor do të jenë vetëm togfjalësha (thënie) ose fjali të shkurtra. Thëniet do të jenë më të shumta dhe pa dëshmim të autorit. Thëniet do të vihen zakonisht kur shprehin nuanca kuptimore e stilistike të fjalës së shpjeguar, lidhje kryesore e specifike të fjalës me fjalë të tjera etj., sikundër është vepruar edhe në fjalorët e mëparshëm shpjegues. Ky tip shembujsh do të paraqitet në përputhje me normën gjuhësore.

Të dhëna plotësuese:

a) Në mikrostrukturën e Fjalorit, në fund të paragrafit leksikografik, do të jepen fjalët me lidhje të drejtpërdrejtë fjalëfomuese (sikundër jepen në disa fjalorë të tillë të gjuhëve të tjera, pas shënimit *Rrjedh.*), të cilat do të vihen në fjalor në vendin e vet, por edhe fjalë që për shkak të kriterëve të përzgjedhjes së fjalësit, nuk do të vihen në fjalor.

b) Fjalori do të ketë një redaksi. Redaktorët do të jenë edhe hartues. Në bashkëpunim me hartuesit e tjerë, redaktorët do të japin zgjidhjet përfundimtare për çështje të diskutueshme. Redaktorët kanë të drejtën t'ia kthejnë hartuesit materialin që nuk ka arritur nivelin për redaktim.

c) Të gjitha materialet për redaktim do të vijnë nga hartuesit të kompjuterizuara.

ç) Me hartuesit, redaktorët e bashkëpunuesit do të lidhen marrëveshje për pranimin e detyrave e të kushteve të pjesëmarrjes në projektin e këtij Fjalori, si dhe për të drejtat e tyre sipas ligjit të autorit.

d) Bashkautorët që nuk janë punonjës efektivë do të punojnë me kontratë dhe me pagë sipas statusit të tyre; sipas VKM, nr. ... , datë ... , neni ... , ata përfitojnë pas botimit të Fjalorit një honorar prej 40%, sikundër punonjës efektivë të Institutit.

Varianti i një Fjalori të madh të gjuhës shqipe, me 120.000-125.000 fjalë, në 4-5 vëllime, kërkon një projekt tjetër, me kërkesa e afate të tjera dhe referimin të "Parimet themelore për hartimin e 'Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe'", hartuar nga Androkli Kostallari (SF, 1968/2) dhe te puna e kryer për dy vëllimet e para.

**Ky draft paraqitet për diskutim në grupin e realizuesve. Ai është hartuar nga Jani Thomai (i ngarkuar nga ASh) dhe Valter Memisha (i ngarkuar nga ASA).*